



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më
28.3.2025, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, (i pavarur), kryesues i Kuvendit, Tiera Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Feim Osmani (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Violeta Salihu (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Petrit Reçica (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbër Limani (LVV), Faton Zeka (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajšhori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Sami Salihu (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Amir Simnica (LDK), Milazim Vitija (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB), Xhavit Ahmeti (AAK), Endrit Zabërgja (NISMA), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Berat Lahu (i pavarur), Edmond Azemi (i pavarur).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Arbër Sadiki, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Florent Maliqi, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe i Drejtorisë së Inspeksionit, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Emergjencave, Donikë Çetta, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Bekim Kastrati, Drejtor i Drejtorisë së Transformimit, Kushtrim Mushica, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Brahim Mehmetaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, përfaqësues të OSBE-së dhe të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Bekim Brestovci, propozoi që të hiqet nga rendi i ditës pika e gjashtë: Propozim-vendimi për subvencionimin e kompanisë rajonale "Pastrimi", në Prishtinë.

Berna Saraçi, propozoi që pika e nëntë e rendit të ditës: Propozim- vendimi për subvencionimin e transportit të nxënësve, të kalojë pikë e dytë e rendit të ditës.

Feim Osmani kërkoi që të futet në rendin e ditës pika: Diskutim mbi gjendjen në stadiumin e futbollit Barileva.

Gëzim Sveçla tha se jemi në dijeni të një intervenimi të Komunës në hapësirat e muzeut "Reporting Houses" dhe ky intervenim përveçse pamundëson mbajtjen e një ekspozite në një pjesë, në një hapësit të saj, afekton edhe një pjesë tjetër, gjë që mund edhe të rrezikojë mbylljen e ekspozitës, e cila nuk është veçse ekspozitë, është një memorie kolektive e një periudhe shumë të rëndë për kombin tonë, duke filluar nga protestat, demonstratat, shtëpitë shkolla, e deri te lufta për liri e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Andaj, kërkojmë nga Kryetari i Komunës që derisa të fillojnë punët për ndërtimin e Sallës koncertale, ky projekti me UNDP-në, të realizohet në një pjesë tjetër, kurse "Reporting Houses" të vazhdojë punën aty ku ka qenë.

Leutrim Retkoceri theksoi se, do të ishte shumë me rëndësi që sot në rend të ditës, para këtij revidimi të planit të Çagllavicës, të jetë edhe raporti i auditorit për ndërtimet e larta për Komunën e Prishtinës, që është skandaloz dhe është krim i vërtetë urban, që kjo qeverisje vazhdon t'i bëjë Kryeqytetit, me ndërtime, me mos reagime në kohë, me keqpërdorime të shumta etj. Sa i përket propozimit të z. Brestovci për heqjen e pikës së gjashtë, që ka të bëjë me subvencionimin e ndërmarrjes "Pastrimi", ne jemi kundër, pasi që mendojmë se të hiqen subvencionet në dëm të punëtorëve, e në dëm të qytetarëve duke rrezikuar, duke u mbyll edhe dyertë e deponive, kjo nuk qëndron.

Muhamet Selmani kërkoi nga të pranishmit që ta mbështesin subvencionimin e ndërmarrjes "Pastrimi", sepse këtu nuk kemi të bëjmë me subvencionim, por kemi të bëjmë me shlyerje të borxhit, të cilin Komuna i ka borxh ndërmarrjes "Pastrimi" për vitin 2024, pa llogaritur shpenzimet dhe borxhet tjera. Po ashtu, propozoi që pika: Diskutim mbi gjendjen në stadiumin e futbollit "Barileva", të jetë pika e tretë në rendin e ditës.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna, si në vijim:

Kryesuesi konstatoi se, më 34 vota për dhe 11 kundër, u miratua propozimi i z. Brestovci, që pika e gjashtë të hiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 36 vota për dhe 4 kundër, u miratua propozimi i znj. Saraçi, që pika e nëntë të jetë pika e dytë në rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për dhe 19 kundër, u miratua propozimi i z. Osmani që në rend të ditës të futet pika: Diskutim mbi gjendjen në stadiumin e futbollit "Barileva".

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 15 kundër, u miratua propozimi i z. Selmani, që pika: Diskutim mbi gjendjen në stadiumin e futbollit "Barileva", të jetë pika e tretë e rendit të ditës.

Me ndryshime dhe plotësime, kryesuesi konstatoi se më 39 vota për, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të seancës së parë dhe të dytë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për subvencionim të transportit të nxënësve;
3. Diskutim mbi gjendjen në stadiumi e futbollit "Barileva";
4. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar artistit Faruk Begolli;
5. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar dëshmorëve Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi;
6. Propozim vendimi për përkrahjen financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar;
7. Propozim-vendimi për definimin e kufirit në mes bllokut A6 dhe A7 të Planit rregullues "Prishtina e Re- Zona Qendër";
8. Rekomandimi për kryetarin e Komunës së Prishtinës lidhur me respektimin e akteve që dalin nga Kuvendi i Komunës;
9. Propozim-vendimi për hartimin e planit të hollësishëm rregullues - Çagllavicë;
10. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor- 31 dhjetor 2024 (TM4);
11. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar- 31 dhjetor 2024 ;
12. Propozim - vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025-2026;
13. Propozim - vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;
14. Propozim - vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtime të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në kryeqytet, nr- 01-020/05-69249/23, dt. 3.4 2023;
15. Propozim - vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031;
16. Propozim - vendimi për miratimin e Rregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës ;
17. Pyetje dhe përgjigje;
18. Të ndryshme.

Para se të kalohet në pikën e parë të rendit të ditës, Berat Lahu para të pranishmëve paraqiti një sqarim rreth ndryshimit të ulseve në Kuvend, me ç' rast tha se, që nga sot nuk jam pjesë e subjektit politik të LVV-së, por tash e tutje do të jem anëtar i pavarur i Kuvendit.

Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të seancës së parë dhe të dytë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se, më 36 vota për dhe 1 kundër, u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të seancës së parë dhe të dytë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë

Propozim-vendimi për subvencionimin e transportit të nxënësve.

Përparim Rama, kryetar, tha se, ristrukturimi i transportit në Kryeqytet fokusohet faktikisht në transportin urban, transportin publik dhe si i tillë kemi bërë propozimin që të subvencionohet transporti i nxënësve, më fokus të madh ndaj nxënësve të kryeqytetit.

Muhamet Selmani propozoi që disa lagje të tjera që janë nëpër qytet dhe fshatra, ku mund të dokumentohet se ka shumë fëmijë që udhëtojnë me një distancë ndoshta mbi 2 km, atyre t'u mundësohet që të subvencionohet transporti dhe mos t'i diskriminojnë nga një e drejtë legjitime për shkollim. Po ashtu, propozoi që autobusi të vazhdojë deri në lagjet "Leci" dhe "Verbovci" të Barilevës, dhe mos të ndalet në mes të fshatit, por kjo linjë të zgjatet deri në skajin e fshatit, që mundësisht t'i transportojë edhe fëmijët nëpër shkolla.

Berna Saraçi kërkoi që sa më parë të funksionalizohet Komiteti për Arsim, me qenë se këtu nuk po diskutojmë shumë për arsimin, Besoj që secili përfaqësues, secila parti ka shumëçka për të thënë dhe me diskutuar të paktën brenda atij komiteti.

Elmire Nikçi - Rexha tha se, në emër të grupit të LDK-së, i përkrahim propozimet e dhëna në lidhje me transportin e nxënësve.

Fiknete Bejta tha se duhet t'i kemi parasysh edhe disa sheqtesime të qytetarëve, konkretisht për ata nxënës që udhëtojnë nga Veternikut, Albi Mall për në shkollën "Dardania" ose në shkollën "Hasan Prishtina", prandaj kisha sugjeruar që të gjejmë një mënyrë, ta amandamentojmë, ose t'i japim një rekomandim nga Kuvendi Komunal që të trajtohet edhe ky shqetësim i qytetarëve. Po ashtu, propozoj që ky propozim-vendim t'i ketë 2 pika që miratohen, me u votua vendimi qysh është propozuar dhe më pas me u bë një analizë mbi vlerësimin 2.5 km një drejtim me nxënës, pastaj me ardhur me një propozim të ri se si të behet kjo analizë, se me konkluzione ne nuk e obligojmë Komunën.

Feim Osmani tha se këtij propozim-vendimi duhet t'i shtohen pika të caktuara dhe të shkurtohet gjatësia e subvencionimit për bartje.

Leutrim Retkoceri tha se në një pikë të këtij propozim-vendimi nuk mund të futen 2 pika, kështu që propozimi është që 4 km të cilat janë të ckura në këtë vendim, të kthehen në 2 km.

Jeta Rafuna tha se pika e parë e këtij propozim-vendimi që ka të bëjë me ndryshimin e gjatësisë prej 4 km në 2 km, është e pranueshme, dhe pika e dytë e vendimit të jetë

që me e obliguar Drejtorinë Financave që deri në mbledhjen radhës, të sjellë propozim dhe analizën e Kuvendit për 2 km plus.

Fatmir Dervishi propozoi që të bëhet subvencionim i transportit për të gjithë nxënësit e komunës së Prishtinës.

Bahri Gashi tha se nuk do të duhej që disa nxënës të kenë privilegj në bartjen e tyre e disa të tjerë të anashkalohen, kështu që mendoj se duhet subvencionuar të gjithë njëjtë, pa ndonjë selektim.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Valbona Makolli dhe Fatos Dibra.

Gëzim Sveçla propozoi që këtij propozim-vendimi t'i shtohen këto pika 1: Në vend të 4 km të bëhet 2 km, në vendet ku nuk ka transport urban, dhe propozimi 2: Të obligohet Drejtoria e Arsimit që, deri në seancën e radhës, të bëjë një analizë për ato vende ku është i nevojshëm subvencionimi i transportit të nxënësve.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna për plotësim - ndryshim të propozim-vendimit.

Kryesuesi konstatoi se më 37 vota për dhe 2 abstenime, u miratuan propozimet e dhëna për plotësim - ndryshimin e këtij propozim- vendimi.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për, u miratua Vendimi për subvencionimin e transportit të nxënësëve.

Pika e tretë

Diskutim mbi gjendjen në stadiumi e futbollit "Barileva".

Feim Osmani theksoi se, duke pasur parasysh gjendjen e stadiumuit në Barilevë, shqetësimet dhe kërkesat e banorëve të këtij lokaliteti, i bëjmë thirrje ekzekutivit që të intervenojë në kohë optimale për t'u dhënë zgjidhje këtyre shqetësimeve, duke votuar si rekomandime në dy çështje:

1. Marrja e veprimeve nga ekzekutivi për mjetet e zotuar në fund të vitit 2023, për buxhetimin e vitit 2024, lidhur me realizimin e kërkesave të fshatrave Barilevë dhe Drenoc, për fushën sportive të klubit të futbollit "Barileva".
2. Definimi i pronës dhe eliminimi i çështjeve pronësore në parcelat në të cilat planifikohet ndërtimi i stadiumit.

Muhamet Selmani propozoi që të formohet një grup punues edhe të shohim se cila ka me qenë zgjidhja më e mirë për ta shtyrë përpara këtë projekt, po edhe ne si asamblistë, nëse është nevoja me t'u bashkëngjitur atij grupi, vullnetin e kemi të gjithë me punuar për të bërë zgjidhje sa më shpejtë që është e mundur dhe me parë se cila është ajo forma më e mirë e zgjidhjes së atij problemi.

Gëzim Sveçla theksoi se ideja është që kësaj çështje t'i jepet një dinamikë më e madhe dhe mendoi se rekomandimet eventualisht i nxjerrë ky Kuvend, vetëm i shërbejnë kësaj rritjes së dinamikës për ta zgjidhur problemin me të cilin na janë drejtuar banorët e asaj zone për rregullimin e stadiumit.

Bahri Gashi tha se përgjegjësia për rregullimin e këtij stadiumi është e ekzekutivit, konkretisht drejtoria përkatëse, kështu që mendoi se rekomandimet e tilla nuk qëndrojnë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha **Brahim Mehmetaj**, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për dhe 14 kundër, u miratuan rekomandimet e propozuara për ekzekutivin e Komunës nga z. **Osmani**.

Pika e katërt

Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar artistit Faruk Begolli.

Lidhur me këtë propozim-vendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Arbër Sadiki**, drerjtor.

Jeta Rafuna tha se ne si GP i LDK-së e votojmë këtë propozim-vendim për caktimin e këtij lokacioni.

Bahri Gashi u shpreh se edhe GP i AAK-së e voton këtë propozim-vendim, por kam një vërejtje, sepse është dashur që këtij propozimi t'i shtohet një biografi e shkurtër për artistin **Faruk Begolli**.

Nora Kelmendi pyeti se si mund të bëhet një caktim i një lokacioni nga Komuna, kur parcela e propozuar për destinim me numër kadastrale P10297, me sipërfaqe 6760 m² është në pronësi të përbashkët të Republikës së Kosovës dhe PSH Kuvendi i Kosovës, pra është dashtë që paraprakisht të bëhet një marrëveshje mes dy institucioneve për këtë lokacion.

Endrit Zabërxha tha se e përkrahim këtë propozim-vendim për miratim për profesorin e nderuar, ish artistin **Faruk Begolli**, duke shfaqur respektin dhe konsideratën gjithmonë si një nga të parët e asaj gjenerate, që ka kontribuar në edukimin dhe frymëzimin e studentëve të asaj kohe, patjetër që duhej sensibilizim për të arritur deri te çlirimi.

Gëzim Sveçla u shpreh se ne asgjë nuk kemi kundër këtij propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e memorialit kushtuar artistit **Faruk Begolli**, por jemi kundër procedurave të cilat nuk po respektohen për aktet e tilla.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerime e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha **Fatos Dibra**, përfaqësues ligjor.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar artistit Faruk Begolli.

Pika e pestë

Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar dëshmorëve Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi.

Për këtë propozim-vendim, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Arbër Sadiku, drejtor.

Gëzim Sveçla tha se e përkrahim këtë propozim-vendim për miratim, por kemi një vërejtje te parcelat ku duhet të bëhet aty një ndarje, sepse është parcela shumë e madhe.

Jeta Rafuna tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim-vendim për caktim të lokacionit.

Leutrim Retkoceri theksoi se përveç ndarjes së lokacionit për realizim të projektit para se të dal publikisht, është mirë me u përfshirë edhe familjet, me u marrë edhe vendimi i tyre, pasi që kjo ka qenë kërkesë edhe e familjarëve.

Bahri Gashi tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim për miratim këtë propozim-vendim.

Endrit Zabërxha u shpreh në përkrahje të këtij propozim-vendim për miratim dhe, po ashtu i bashkohemi kërkesës që në këtë caktim të bashkëpunohet dhe të diskutohet me familjet, në mënyrë që edhe ky vendim të jetë i harmonizuar nga të gjitha palët.

Kryesuesi konstatoi se më 39 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar dëshmorëve Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi.

Pika e gjashtë

Propozim - vendimi për përkrahjen financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar

Lidhur me Propozim - vendimin për përkrahjen financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Adelina Sahiti, drejtore.

Arbnora Berisha tha se duke pasur parasysh këtë propozim-vendim dhe njëkohësisht duke i pasur për bazë disa ndryshime, ne po kontribuojmë në një mbështetje më të qëndrueshme dhe më të fuqishme për familje strehuese, si dhe një mundësi më të mirë për ata që janë në nevojë, prandaj Lëvizja Vetëvendosje propozon që vlerat e propozuara për të gjitha kategoritë të rriten për 50% dhe lus kryesuesin e Kuvendit që ky propozim të hedhet në votim.

Endrit Zabërxha theksoi se e përkrahim për miratim këtë propozim-vendim, por besoj se do të trajtohet edhe propozimi i dhënë nga Lëvizja Vetëvendosje.

Arianit Beqiri kërkoi nga drejtoria përkatëse të dijë se:

- si është ideja e drejtorisë për disa kategori të tjera, të cilat mbulohen prej drejtorisë, si p.sh. grupet e marginalizime, për të moshuarit, por edhe për gratë e dhunuara;
- si është aktiviteti i tyre social edhe kulturor edhe tek këta të rinjtë, a punohet që këta mos me qenë pjesë e shkëputur prej shoqënisë dhe
- si është programi që edhe me një moment të caktuara edhe këta të rinjë me qenë të pavarur prej familjeve, por edhe prej të tjerëve.

Berna Saraqi tha se, nëse në të ardhmën shtohet ky numër prej familjeve strehuse dhe fëmijëve që janë në këtë gjendje, kisha dashtur një rekomandim të vogël sidomos për kategorinë e personave me aftësi të kufizime, që të trajtohen me një shumë më të madhe të mjeteve financiare, sepse një aftësi e kufizime ka shpenzime tjera, ndërsa një tjetër mundet me pasur tjera shpenzime.

Jeta Rafuna tha se edhe ne e përkrahim për miratim këtë propozim-vendim, por edhe propozimin për rritjen e skemave ndihmëse prej 50%.

Bahri Gashi tha se edhe ne e përkrahim për miratim këtë propozim-vendim, por gjithsesi këto kategori të personave me nevoja të kufizuara duhet me i ndihmuar maksimalisht, qoftë edhe me rritjen e këtyre vlerave, çdo gjë me bë në drejtim të tyre, sepse ata e meritojnë dhe kanë nevojë.

Gresa Lahu tha se ne si GP i PDK-së, këtë propozim-vendim e përkrahim për miratim.

Lidhur me sugjerimet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dha Adelina Sahiti, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për, u miratua Vendimi për përkrahjen financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar.

Pika e shtatë

Propozim-vendimi për definimin e kufirit në mes bllokut A6 dhe A7 të Planit rregullues "Prishtina e Re- Zona Qendër"

Për këtë propozim-vendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Arbër Sadiku, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, u miratua Vendimi për definimin e kufirit në mes bllokut A6 dhe A7 të Planit rregullues "Prishtina e Re- Zona Qendër".

Pika e tetë

Rekomandimi për kryetarin e Komunës së Prishtinës lidhur me respektimin e akteve që dalin nga Kuvendi i Komunës.

Leutrim Retkoceri tha se, sa i përket rekomandimeve ka derivu si nevojë e kohës dhe situatës në të cilën gjendet Kryeqyteti me meanxhimin e mbeturinave, edhe disa obligimeve që dalin dhe janë përgjegjësi e Kryetarit të Komunës. Mendoj se është me rëndësi të diskutohen disa, e që është një situatë që në mungesë të përmbushjes së obligimeve që dalin nga marrëveshja e nënshkrime me KfV-në, komunat e rajonit të

Prishtinës dhe ndërmarrjes "Pastrimi", po rrezikojnë të humben rreth 70.4 milionë euro të grandit dhe kredisë së KfV-së, që do të ishte një goditje jashtëzakonisht e rëndë për situatën me menaxhimin e mbeturinave në Kryeqytet, dhe për këta nuk ka se si të mos ketë përgjegjësi ekzekutivi, Kryetari i Komunës dhe akterë të tjerë ekzekutivë.

Rreth këtyre rekomandimeve kam disa pyetje, në veçanti për drejtorin z. Brestovci, kërkoi të dijë: A keni qenë ju apo kryetari i Komunës, që keni lëshuar njoftimin zyrtar për mos pagesë të faturës së mbeturinave, ndërmarrjes publike? Pyetja e dytë është: Kush ka nxjerrë vendim për suspendimin e rregullores, pra kush ka qenë urdhërues i këtij vendimi?

Gëizm Sveçla tha se është më se e nevojshme që t'i përdorim të gjitha mundësitë ligjore që i kemi, në mënyrë që të përmirësohet gjendja me mbeturina e cila mbizotron në Kryeqytet, e për të cilën besoj që të gjithë jemi njëzëri se nuk është ajo që dëshirojmë. Ky nuk është një problem që ka lindur, tani është shumë e qartë që në betejën për pastrimin ka dy palë dhe ka një viktimë, e që viktima janë qytetarët e Prishtinës dhe qyteti ynë, e që kjo çështje nuk po rregullohet tash e 3 vjet e gjysmë. I mbështesim rekomandimet të cilat e obligojnë Kryetarin e Prishtinës që t'u përmbahet kontratave dhe marrëveshjeve të cilat, çfarëdo qofshin ato, dhe të cilat i ka firmosur çoftë me ndërmarrjen "Pastrimi", çoftë me donatorë të jashtëm, me të vetmin qëllim që kjo t'i shërbejë përmirësimit të gjendjes. Ne nuk do ta lejojmë në asnjë mënyrë bankrotimin e ndërmarrjes "Pastrimi", prandaj nga këtu i ftojme të dy palët që të gjejnë gjuhën e përbashkët dhe ta kryejnë detyrën e vetë konform autorizimeve dhe kompetencave që i kanë, në mënyrë që Prishtina të jetë një Kryeqytet i pastër, çfarë e meritojnë qytetarët e Prishtinës.

Granit Geci theksoi se në këtë situatë që qjendet Prishtina, por nuk është se ka qenë ndonjëherë më mirë ose më keq, afërsisht kështu ka qenë gjithmonë pas luftës në Prishtinë, sepse asnjë herë nuk e keni trajtuar seriozisht çështjen e Prishtinës. Ne sot para vetës e kemi një marrëveshje, e cila konsideroj se do ta zgjidhte përfundimisht problemin e manxhimit të mbeturinave, dhe kemi një insistim të anës tjetër të kryetarit Rama dhe të miqve të kabinetit të tij, që në asnjë formë të mos mbërrijmë tek ajo formë, tek ajo marrëveshje, tek ai zbatim, sepse është përballë një kontratë tjetër në vlerë prej 16.5 milionë euro, e cila kjo drejtori i ka mundësuar marrjen e këtij tenderi ndonjërit prej të afërmeve të ekzekutivit dhe ne konsiderojmë se kjo është tejet shqetësuese. Lidhur me këtë shoh se si anëtar të Kuvendit kemi vërejtje dhe prej Kuvendit kemi interesim që me u ulur bashkarisht edhe me gjetë një zgjidhje, përveç ekzekutivit që nuk është i intersuar për zgjidhjen e këtij problemi!

Faton Zeka u shpreh se, duke pasur parasysh gjendjen në këtë ndërmarrje, mendoj që asgjë parimore këtu nuk ka, në njërën anë kemi një keqmenaxhim të asaj ndërmarrjeje me mbipopullim të punëtorëve, dhe në anën tjetër kemi një bllokim të Komunës karshi ndërmarrjes pastrimi. Gjithashtu, është për keqardhje me tentuar me bankrotuar një ndërmarrje, por ne urojmë që të dy palët të heqin dorë prej interesave të veta dhe t'i qesin në pah interesat e qytetarit të Prishtinës dhe të punëtorëve të ndërmarrjes "Pastrimi".

Muhamet Selmani tha se Rregullorja e miratuar në këtë Kuvend lidhur me "Pastrimin", është pezulluar me një vendim të Zyrës ligjore të Komunës, që për mua

nuk është e drejtë, sepse të drejtën e pezullimit të saj e ka vetëm një vendim i gjykatës dhe në këtë vendim nuk e kemi pranuar, kështu që kërkoj nga kryesuesi i Kuvendit të na i sigurojë këtë vendim të gjykatës. Pa këtë vendim të pezullimit, Rregullorja mbetet në fuqi dhe duhet të zbatohet. Çdo vendim tjetër është i paligjshëm dhe përben vepër penale. Po ashtu, është edhe një vendim, ku janë të regjistruara 97 mijë familje, të cilat duhet të paguajnë për mbledhje të mbeturinave në komunën e Prishtinës. Realisht, Komuna e Prishtinës ka kontratë vetëm për 72 mijë klientë, ndërsa për 25 mijë klientë të tjerë, edhe pse ndërmarrja "Pastrimi" i grumbullon mbeturinat, ju nuk e paguani asnjë cent. Kërkojmë që të korrigohet ky vendim.

Bahri Gashi tha se sa i përket gjendjes së krijuar në kompaninë "Pastrimi", mendoj se atyre punëtorëve duhet me i'u dalë në ndihmë, duhet bërë një zgjidhje dhe duhet ecur sa më shpejt përpara. Uroj që ky problem të zgjidhet sa më shpejtë, për të mirën e të gjithë qytetarëve.

Endrit Zabërxha tha se në si drejtues dhe si njerëz që bartin përgjegjësi publike, na takon të synojmë zgjidhjen e problemit para se të komplikohet, kështu mendoj që z. Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ka arritur një prej arritjeve më të mëdha, ndoshta me realizimin e punëve të cilat i kanë takuar atij në drejtorinë e vet.

Unë në asnjë mënyrë nuk jam për falimentimin e "Pastrimit", në asnjë mënyrë nuk jam për me i lënë punëtorët pa punë, mirëpo jam që të diskutohen, të gjinden zgjidhjet ashtu siç ka shumë e shumë shërbime të nevojshme Kryeqyteti me i angazhuar ata punëtorë, ndoshta edhe me punë më të lehta, mirëpo Prishtinën me e pastruar.

Sami Borovci tha se e ndiej obligim me e sqaruar edhe me e pasë të qatë krejt, se në mandatin e kaluar kemi qenë aksionarë për një periudhë ndoshta 7 mujore, edhe normalisht e kemi nënshkruar një bonus të performancës, që është i mbështetur në ligj, domethënë gjithçka ka qenë baza ligjore, opinionimi i Zyrës ligjore edhe për anëtarë e bordit. Ky vendim i ka kaluar të gjithë filtrat ligjorë, e ka kaluar edhe raportin e auditorit që nuk ka pasë asnjë gjetje, kështu që ka qenë një vendim i bazuar plotësisht në ligj.

Jeta Rafuna tha se në mandatin e kaluar kemi nënshkruar një bonus, i cili ka qenë ligjërisht krejtësisht i bazuar në ligj dhe deri më sot unë nuk jam ftuar asnjëherë as nga prokuroria, e as nga policia për këtë nënshkrim të këtij dokumenti, kështu që prapë bëjë thirrje, për atë vendim të ligjshëm që ka kaluar të gjitha filtrat le të urdhërojnë, ta dërgojnë në prokurori dhe në hetuesi, dhe unë jap përgjegjësitë e mija.

Gresa Lahu theksoi se ndiej keqardhje për një fjali të cilën e potencoi drejtori tashmë i Inspektionit dhe drejtor i Shërbimeve Publike, i cili e akuzoj drejtë për drejtë Partinë Demokratike për gjendjen kaotike të mbeturinave në kryeqytet, duke e ditur që Partia Demokratike nuk udhëheqë me ekzekutivin dhe se ai tashmë ka bërë po thuajse një vit që e ka marrë mandatin e tij në udhëheqje të kësaj drejtorie, pikërisht për shkak të vendimit të kryetarit Rama, për shkarkimin e ish-drejtorit të atëhershëm, kështu që ju lus që ta merreni me më shumë përgjegjësi gjendjen e

mbeturinave në kryeqytet, sepse kjo është një detyrë e ekzekutivit, e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Lidhur me vërejtje dhe sugjerimete dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Bekim Brestovci, drejtor dhe Fatos Dibra, përfaqësues ligjor.

Kryesuesi konstatoi se më 10 vota për dhe 17 kundër, nuk u miratua Rekomandimi për kryetarin e Komunës së Prishtinës lidhur me respektimin e akteve që dalin nga Kuvendi i Komunës.

Pika e nëntë

Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues - Çagllavicë;

Lidhur me këtë propozim-vendim, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Arbër Sadiki, drejtor.

Pas diskutimit të z. Sadiku, kryesuesi bëri verifikimin e kuorunit, ku në sallë ishin 23 anëtarë të Kuvendit dhe në mungesë të kuorunit, e konstatoi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 15:47.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesues i Kuvendit
Fehmi Kupina

